



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **69/2024**

Data: **18.12.2024. Ora: 13: 30**

Vendi: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Aktivitetet e Zyrës:

- 2.1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit të Zyrës për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës që mbahen me datën

9 shkurt 2025 (pjesa e parë)

3. Raport i Këshillave të KQZ

3.1. Këshilli për Personel

3.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i kompensimit të stafit të Sekretariatit të KQZ-së, për punën me vëllim të shtuar

3.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Divizionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me angazhimin e personelit të përkohshëm për procesin e zgjedhjeve

4. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Pas paraqitjes së agjendës nga kryetari Radoniqi, ai propozoi që të futen në rend të ditës procesverbalet nr. 67 dhe 68. Ndërsa, z. Arianit Elshani propozoi nga KOZ një pikë: ndryshimi i anëtarëve të KKZ nga Deqani dhe komuna e Shtimes nga radhët e subjektit politik IRDK. Ibrahim Selmanaj, tha se ngase ka ecur mirë çështja me subjektet, si aplikimi dhe certifikimi i kandidatëve, ai propozoi që pavarësisht planit operacional, KQZ ta bëjë tërheqjen e shortit para vitit të ri. Do të ishte e favorshme edhe për subjektet, po edhe për KQZ. Alban Krasniqi, e përkrahu këtë propozim. Ai, tha se më shumë se sa propozim i z. Selmani, ndoshta është mirë të diskutohet dhe shqyrtohet i gjithë plani, pra të rivlerësohet mundësisht plani në ditët e ardhshme. Kreshnik Radoniqi, tha se KOZ-i mbase është mirë ta rishikoj, dha vlerësoj këtë dhe të vendoset edhe për short, edhe për çështje tjera.

Me 9 vota për, miratohet agjenda e takimit.

Në vazhdim, me 9 vota për, anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalet nr. 67 dhe 68/2024.

2. Aktivitetet e Zyrës:

- 2.1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit të Zyrës për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës që mbahen me datën 9 shkurt 2025 (pjesa e parë):

Besnik Buzhala: Sot, zyra ka përgatitur grupin e parë të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për certifikim që marrin pjesë në zgjedhjet për Kuvend të 9 shkurtit. Periudha e aplikimit për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që mbahen me datën 09.02.2025, ka filluar me datën 1 shtator 2024 dhe ka përfunduar me datën 11 dhjetor

2024, në ora 23:59¹. Siç përcaktohet me Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/2024 - Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre, secili subjekt politik që do të certifikohet, ka përmbushur këto obligime: 1. Deklaratën politike. 2. Listën e kandidatëve me njëqind e dhjetë (110) kandidatë dhe formularët e aplikimit për secilin kandidatë. Lista e kandidatëve përmban: gjashtëdhjetë e nëntë (69) kandidatë burra, ose 63%; dyzet e një (41) kandidatë gra, ose 37%. Listat e kandidatëve të subjekteve politike që kanë aplikuar, gjithashtu kanë kaluar nëpër filtrat e paraparë ligjorë dhe në institucionet të cilat, edhe i kanë verifikuar dosjet e kandidatëve – përshtatshmërinë dhe integritetin e tyre.

Janë gjithsej, 11 subjekte politike të cilat, janë aktualisht pjesë e parlamentit dhe lirohen nga taksat. Aplikimi, është bërë në mënyrë elektronike. S'i më poshtë, raporti i zyrës përfshinë 606 kandidatë. Subjektet dhe kandidatët, u votuan veç e veç:

1. Lëvizja VETËVENDOSJE! (110 kandidatë: 69 kandidat burra, dhe 41 gra. Me 10 vota për, certifikohet)
2. PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (110 kandidatë: 72 burra dhe 38 gra. Me 10 vota për, certifikohet)
3. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (110 kandidatë: 72 burra, 38 kandidatë gra. Me 10 vota për, certifikohet)
4. KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI (25 kandidatë: 16 burra, 9 kandidatë gra. Me 10 vota për, certifikohet)
5. SOCIJALDEMOKRATSKA UNIJA (40 kandidatë: 25 burra: 15 kandidatë gra. Me 10 vota për, certifikohet)
6. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS (41 kandidatë: 26 burra, 15 kandidatë gra. Me 10 vota për, certifikohet)
7. KOALICIJA VAKAT (48 kandidatë: 31 burra, 17 kandidatë gra. Me 10 vota për, certifikohet)
8. PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM (35 kandidatë: 24 burra, 11 kandidatë gra. Me 10 vota për, certifikohet)

¹ Vendimi i KQZ, Nr. 01/2162 – 2024, datë 11.12.2024.

9. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA (46 kandidatë: 29 burra, 17 kandidatë gra. Me 10 vota për, certifikohet)
10. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA (29 kandidatë: 20 burra, 9 kandidatë gra. Me 10 vota për, certifikohet)
11. ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK (12 kandidatë: 8 burra, 4 kandidatë gra. Me 10 vota për, certifikohet)

3. Raporti i Këshillave të KQZ-së

1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimit të anëtarëve të KKZ nga komuna e Deçanit dhe komuna e Shtimes nga radhët e subjektit politik IRDK:

Arianit Elshani: KOZ-i, tha Elshani ka shqyrtuar këto ndryshime. Bëhet fjalë për dy anëtarë, për shkak të dorëheqjes së tyre në këto dy komuna. Emrat që janë sjellë në KOZ, kanë kaluar filtrat e duhur. Prandaj, rekomandojmë për miratim.

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Deqanit, Qëndrim Jollaj zëvendësohet nga Liridon Tetaj nga subjekti politik IRDK. Me 10 vota për, miratohet.

Dhe në komunën e Shtimes, Arjeta Maliqi, zëvendësohet me Driton Veliajn, po ashtu nga IRDK. Me 10 vota për, miratohet.

2. Këshilli për Personel

Shqyrtimi dhe miratimi i kompensimit të stafit të Sekretariatit të KQZ-së për punën me vëllim të shtuar:

Alban Krasniqi: Në lidhje me këtë pikë që e kemi diskutuar edhe në punëtori, mirëpo edhe për disa arsye stimuluese sepse jemi në proces zgjedhor, por kemi marrë edhe rekomandim nga Sekretariati që ta shqyrtojmë e miratojmë kërkesën: marrjen e 20 % të pagës për muajin nëntor dhe dhjetor, ashtu siç është e mundshme edhe me ligjin për zyrtar publik, me rregulloren e KQZ. Është hartuar draft-vendimi, dhe ne rekomandojmë për miratim.

Në këtë pikë, u diskutua lidhur me personat “Nita Mustafa, Besnik Buzhala dhe Selime Doli” në kontekst me pagesat shtesë që lidhen me vëllimin e shtuar por, edhe me 20%-in, interferimet që lidhen me thesarin etj.

Me 10 vota për, miratohet.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Divizionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me angazhimin e personelit të përkohshëm për procesin e zgjedhjeve:

Alban Krasniqi: Edhe në Tiranë, e diskutuan çështjen e pagesave të stafit shtesë me kohë në mënyrë që të mos shfaqen vonesa. Pastaj, për shkak të ngarkesave dhe nevojave, ideja ishte që të angazhohen edhe 2 persona si staf mbështetës në departamentin për buxhet dhe financa. Pra, dy persona në një pozitë. Fjala është për staf të përkohshëm. Rekomandojmë për miratim.

Me 10 vota për, miratohet kjo kërkesë.

4. Të ndryshme !

Besnik Buzhala: Çështja ka të bëjë me personel...! Ka dy javë që, për drejtorin e Sekretariatit është marrë vendim që unë të autorizohem të lidh marrëveshje me palë të treta. Unë, jam dakorduar që Adelina Daku të vazhdoj si ZKF deri sa të zgjidhjet çështja e zyrtarit financiar për buxhet dhe financa. Ky, është një informacion për ju...

Kreshnik Radoniqi: A kemi diçka tjetër, ndonjë mbledhje...? Duhet ta kemi certifikimin e radhës nga zyra, KOZ-i...

Sami Kurteshi: Çështja e komisionarëve, trajnimin për votimin me jashtë në përfaqësitë diplomatike si kemi me b’a...?

Arianit Elshani: Janë dy modele: krijimi i një videoje që është për trajnim, dhe krijimin e një platformë elektronike: pra, trajnimin ta bëjmë on-line...